



Rregullat për përdorimin e markës së çertifikimit

1. TË PËRGJITHSHME

RIGCERT inkurajon klientët e çertifikuar të përdorin markën e çertifikimit dhe ti referohen çertifikimit të sistemit të menaxhimit për periudhen në të cilën çertifikimi i marë është i vlefshëm por duke respektuar rregullat e përcaktuara në këtë dokument.


Klientët e çertifikuar mund të mos e përdorin markën e çertifikimit.

Marka e çertifikimit i trasmetohet secilit klient të çertifikuar, në format elektronik mbas finalizimit me sukses të aktiviteteve të çertifikuara.

E drejta për të përdorur markën e çertifikimit i përket kompanisë të çertifikuar dhe nuk mund të transferohet nga pale të treta.

2. FORMATI

Formati i markës së çertifikimit është i prezantuar në tabelën e mëposhtme:

 <p>MANAGEMENT SYSTEM CERTIFIED RiG CERT ISO 9001</p>	<p>Standarti(et) e përmendura në fushën e markës së çertifikimit (në këtë rast ISO 9001) janë në përpuethshmëri me çertifikatat e mara nga kompania.</p> <p>Klientët e çertifikuar mund të përdorin versionin me ngjyra të çertifikimit ose versionin bardhë e zi, siç e shih të përshtatshme në varësi të situatës.</p>
---	--

3. RREGULLAT PËR PËRDORIMIN E MARKËS SË ÇERTIFIKIMIT

Klientët e çertifikuar mund të përdorin markën e çertifikimit në website, dokumentacione të përdorura për komunikim, kartëvizita ose në ndonjë mënyrë tjetër, me qëllime reklamimi. Marka e çertifikimit duhet përdorur në formatin e trasmetuar nga RIGCERT. Marka mund të zmadhohet dhe zvogëlohet por duke respektuar proporcionet dhe pamjen me kusht që teksti të mbetet i lexueshem.

Marka e çertifikimit duhet vendosur në të njëjtën faqe ku ndodhet dhe marka e marë nga kompania dhe nuk duhet të jetë ndryshe nga pronari i komunikimit / dokumenti në fjalë.

Marka e çertifikimit mund të përdoret vetëm për periudhën në të cilën çertifikimi i sistemit të menaxhimit është i vlefshëm në përputhje me aktivitetet që janë të përfshira në fushën e çertifikimit.

Në rast se çertifikimi anulohet, klienti do të ndërpresë përdorimin e markës së çertifikimit.

Në rastin kur fusha e çertifikimit është reduktuar, përdorimi i markës së çertifikimit duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat në mënyrë që të mos të përdoret për aktivitete jashtë fushës së çertifikimit.

Marka e çertifikimit nuk duhet të vendoset në produkt apo paketimin e produktit të kompanisë ose në ndonjë mënyrë tjetër që mund të interpretohet edhe që tregon vërtetimin e konformitetit të produktit.

RIGCERT nuk do të lejojë përdorimin e markës së çertifikimit për fletët e votimit dhe raportet e testimit laboratorik / kalibrimeve ose raportet e inspektimit dhe çertifikatat. Të gjitha këto janë konsideruar të jenë produkte të ngjashme.

4. REFERENCAT E ÇERTIFIKIMIT

Klientët e çertifikuar mund të përdorin deklaratën me qëllim çertifikimin e sistemit të menaxhimit i cili përfshin një identifikim të qartë të klientit të çertifikuar, kohën e çertifikimit të sistemit të menaxhimit dhe standartin dhe organizatën e çertifikimit.

Një shembull i kësaj deklarate është "[Emri i kompanisë]" zotëron një sistem menaxhimi të cilësisë të çertifikuar sipas ISO 9001 nga RIGCERT.

Një deklaratë e tillë mund të vendoset në paketimin e produktit ose në informacionin që shoqëron produktin.

5. KONTROLLI

Përdorimi i markës së çertifikimit dhe referimi i çertifikimit janë të vlerësuara gjatë çdo auditi mbikqyrës dhe çertifikimi.

Mospërputhjet në këtë aspekt mund të çojnë në pezullimin apo edhe tërheqjen e çertifikimit nëse nuk trajtohet siç duhet nga kompania.

Jokonformiteti në lidhje me këtë aspekt mund të çojë në pezullimin ose për më tepër në tërheqjen e çertifikimit nëse nuk trajtohen siç duhen nga subjekti.

Përdorimi i markës së çertifikimit dhe referenca për çertifikim do bëhen në mënyrë të tillë që mos të influencojnë në mënyrë negative imazhin e RIGCERT apo sistemin e çertifikimit.

6. ÇËSHTJE TË TJERA

Për disa skema çertifikimi mund të egzistojnë dhe marka të tjera (prone e palëve të treta) të cilat mund të përdoren nga klientët e çertifikuar sipas rregullave të vendosura nga pronarët e tyre. RIGCERT informon klientët e çertifikuar në lidhje me këtë çështje.

Klientët e çertifikuar gjithmonë mund të kërkojnë informacione dhe pikëpamje shtesë për përdorimin e markës së çertifikimit dhe referuar çertifikimit.